



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM
PROCEDUR E NEGOCUAR ME SHUMË OPERATORË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, U.D. i Menaxher-it të Prokurimit, Rruga “Fadil Ferati” Nr. 121 në njërën anë;

dhe

“ECO SOLUTION” SHPK, të cilën e përfaqëson, Drejtori Ekzekutiv, z. Rromir Shala me nr. Unik të Biznesit, 811436478 (ne vazhdim “Kontraktuesi”), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIMI I SHKOLLAVE ME MJETE DEZINFEKTIMI SIPAS MASTER PLANIT PËR ZHVILLIMIN E MESIMIT NË KUSHTE PANDEMIJE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021

Nr. I prokurimit	633 – 20 – 5490– 125 C389
I brendshëm	633-020 / 098 / 125

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është furnizimi dhe instalimi i paisjeve si në vijim:

FURNIZIMI I SHKOLLAVE ME MJETE DEZINFEKTIMI SIPAS MASTER PLANIT PËR ZHVILLIMIN E MESIMIT NË KUSHTE PANDEMIJE PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021

2 Çmimi

2.1 Çmimi i kësajë kontrate në total është: **29.300,00 €**
dhe me fjalë */Njzetenëntëmijëetreqindeuro/*

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit te së njëjtës, perkatesisht, me se larti deri me: 24.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk permbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet për dëmet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- Plani per meaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të

dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:

"ECO SOLUTION" SHPK

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Rromir Shala
Pozita:	U.D. I Menaxher-it të Prokurimit	Pozita:	M e n a x h e r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.10.2020	Data:	23.10.2020
Vula:		Vula:	

Numri i Prokurimit: 633-020-098-125- Titulli: FURNIZIMI I SHKOLLAVE ME MJETE TE DEZINFEKTIMIT SIPAS MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E MESIMIT NE KUSHTE PANDEMIJE PER VITIN SHKOLLORE 20 21.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmspërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmspërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Numri i Prokurimit: 633-020-098-125– Titulli: FURNIZIMI I SHKOLLAVE ME MJETE TE DEZINFEKTIMIT SIPAS MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E MESIMIT NE KUSHTE PANDEMIJE PER VITIN SHKOLLORE 20 21.

	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresen e menaxherit të Projektit]</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <i>[është 10% i vlerës së kontratës.</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK. a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA IV E KONTRATËS:

MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: [emri i autoritetit kontraktues]
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: